



Prishtinë, 07 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1419_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, paragrafi 3 dhe 4, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 51 dhe 72, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, Nenit 37, Nenit 38 dhe Nenit 62 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 5 dhe 6 të Rregullën Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) ;
- Dispozitat e Nenit 17 të Licencës për Furnizim me energji elektrike lëshuar ndërmarrjes "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C, me numër licence ZRRE/Tr_2014/Li_07/17, e datës 27.04.2017,
- Raportit të ZRRE lidhur për Vlerësimin e Konkurrencës së tregut të energjisë për vitet 2018 dhe 2019, të dhjetorit 2020, dhe
- Raportin e Vlerësimit të Furnizimit nën Kushte të Shërbimit Universal,

në seancën e mbajtur më 07 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M
PËR VENDOSJEN E OBLIGIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK

- I. I Vendoset të Licencuarit për Furnizim me energji elektrike "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESC) J.S.C (në tekstin në vijim "KESCO"), Obligimi i Shërbimit Publik për furnizim të konsumatorëve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal.
- II. Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë:
 - a. të gjithë konsumatorët familjar;
 - b. Konsumatorët jo-familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë së dhjetë milion euro (10,000,000 €), ose jo më shumë së pesëdhjetë (50) punonjës, dhe
- III. Përfundimisht pikës II. të Dispozitivit të këtij Vendimi, të gjithë konsumatorët fundor të kyçur në nivelin e Shpërndarjes (35kV, 10kV dhe 0.4kV) kanë të drejtë të furnizohen nën kushtet e shërbimit universal deri në krijimin e kushteve për furnizim në kushtet e tregut .
- IV. Rregullatori do të rregullojë çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, të cilat mbulojnë kostot e arsyeshme të furnizimit me energji elektrike.

- V. Niveli i kostove për furnizim me energji elektrike dhe i çmimeve do të rishikohen në baza vjetore, në pajtim me Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal.
- VI. Furnizuesi i ngarkuar me Obligimin e Shërbimit Publik, sipas këtij vendimi obligohet që të:
- furnizojë me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të përcaktuara me këtë Vendim, me licencë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi;
 - informojë konsumatorët (blerësit) për të drejtat e tyre dhe kushtet e furnizimit në kuadër të shërbimit universal;
 - furnizojë me energji elektrike të një cilësie të caktuar sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit;
 - faturtojë energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e përcaktuara nga Rregullatori;
 - publikojë tarifat në faqen e vet të internetit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit.
- VII. Ky Vendim do të jetë pjesë përbërëse e Licencës për Furnizim me energji elektrike të lëshuar "KESCO"-s.
- VIII. Obligimi i ngarkuar KESCO-s sipas këtij Vendimi vlen deri më datë 31.03.2022.

ARSYETIM

- ZRRE me Vendimin V_916_2017 të datës 27 prill 2017 i ka vendos KESCO për periudhën 3 vjeçare, nga 01.04.2017 deri 31.03.2020, Obligime të Shërbimit Publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal.
- Obligime të Shërbimit Publik si rezultat i mungesës së konkurrencës efektive dhe me qëllim të sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike si dhe mbrojtjes së konsumatorëve,
- Me Vendimin V_1268_2020 të datës 03 korrik 2020 nga arsyet e njohura të asaj kohe e që lidheshin me Pandeminë KOVID19, Obligimin e Shërbimit Publik i ka vazhduar KESCO-së edhe për një vit, duke mbuluar periudhën nga 01.04.2020 deri më 31.03.2021. Lidhur me këtë vendim është njoftuar edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
- Në mungesë të kuorumit të Bordit të ZRRE-së për ta trajtuar këtë çështje, ZRRE përmes komunikimit zyrtar të datës 31 mars 2021 ka njoftuar KESCO se obligimi i mbetet deri me kompletimin e Bordit të ZRRE.
- ZRRE me Vendimin V_1339_2020 të datës 10 dhjetor 2020 ka miratuar Raportin për Vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI) të pjesëmarrjes së furnizuesve në treg.
- ZRRE në muajin tetor të vitit 2021 ka bërë Raportin e Vlerësimit të Furnizimit nën Kushte të Shërbimit Universal dhe matjet e indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI) për vitin 2020.
- Rezultati nga Raportet e cekura më lartë tregojn se ekziston përqëndrim shumë i lartë në tregun me shumicë dhe atë me pakicë, që nënkupton se tregu i energjisë elektrike në vend ende ballafaqohet me mungesë të konkurrencës.

- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar se Obligimi i Shërbimit Publik të vendoset KESCO-së, për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IX. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- X. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi i dërgohet:
KESCO,
KEDS,
KOSTT, dhe
Arkivit të ZRRE-së